

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERSONALITET JURIDIK TË
KUFIZUAR
“OGILVY”SH.P.K.

Sot, në datë 8 Tetor 2005(dymijë e pesë), me cilësinë e ortakëve themelues të poshtëshënuarit:

- -Ortaku “A.T.T.P. Advertising Societe Anonyme” S.A., një shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit të Republikës së Greqisë, me seli në 67 Tzavela Str. & Mesogion Av., 152 31 Halandri, Athinë,Greqi, e regjistruar me nr. 47131/01AT/B/00/447, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Znj. Aimilia TSEIMAZIDOU, e bija e Giorgios, nënshtetase e Republikës së Greqisë, e lindur në Atikë më 04.11.1958, me banim në Athinë,mbajtëse e pasaportës nr. B506677, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar.
- -Ortaku Mojmir OCVIRK, i biri Antonit, nënshtetas i Republikës Slloven, i lindur në Celje, më 16.11.1961, me banim në Kolajbova 13, Ljubljana, Slloveni, mbajtës i pasaportës me nr. P01096404, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar.
- -Ortaku Fisnik ISMAILI, i biri i Muharremit, nënshtetas i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, i lindur në Prishtinë, më 03.06.1973 me banim në 134 Trellick Tower 5 Golborne Road, Londër W10 5UR , Britani e Madhe, mbajtës i pasaportës me nr. 094166345 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar.
- -Ortaku Valon XHAFERI, i biri i Agimit, nënshtetas i Mbretërisë së Norvegjisë, i lindur në Prishtinë, më 14.09.1972, me banim në Rrugën “Hajdar Dushi” 12, 10000 Prishtinë, Kosovë, mbajtës i pasaportës me nr. L0117357/1madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar

kanë vendosur themelimin e shoqërisë sh.p.k. “OGILVY”


Me nënshkrimin e këtij akti themelimi të një shoqërie tregtare, nënshkruesit dhe themeluesit e saj (përfaqësuesit e mandatuar) marrin përsipër të realizojë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet me precizimet e mëposhtme :


NENI 1


Në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar Nr.7638 datë 19.11.1992 është formuar shoqëria tregtare “Ogilvy” sh.p.k .

NENI 2

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë (Shqipëri), me adresë tek Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Zyra A2, Kati V, Kulla II,







Kohëzgjatja e aktivitetit parashikohet te jete 30 vjet , por ky afat mund të ndërpritet apo të zgjatet më tej , gjithmonë në funksion të kompetencave të ortakut të vetëm themelues apo dhe në funksion të marrdhenieve të biznesit që do të realizohen me shoqëritë e tjera tregtare. Në funksion edhe të këtij bashkëpunimi , krijohet shoqëria “Ogilvy”sh.p.k .

NENI 3

Si rregull aktiviteti i shoqërisë mund të zhvillohet në të gjithë territorin e R. Shqipërisë, jashtë këtij territori , me hapjen e filialeve apo nëpërmjet veprimtarive të tjera të karakterit tregtar, në përputhje me legjislacionin përkatës .

NENI 4

Themeluesi e Shoqërisë “Ogilvy”, me këtë akt themelimi të mësipërm, marrin përsipër që të respektojnë të gjitha detyrimet që parashikon legjislacioni tregtar e civil shqiptar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar si dhe ti përmbahen kriterit të respektimit të politikës tregtare që zhvillohet sot në Republikën e Shqipërisë.

NENI 5

Shoqëria “Ogilvy” sh.p.k. , ka vulën e saj të ndërtuar në formë katërkëndëshe, ku shkruhet në qendër të saj : “OGILVY” sh.p.k. si dhe NIPTI dhe në pjesën e sipërme “REPUBLIKA E SHQIPËRISË ” .

NENI 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë “Ogilvy” SH.P.K në momentin fillestar të krijimit është 100,000(njëmilion) lekë i cili regjistrohet në llogarinë e shoqërisë pranë Raiffeisen Bank.

Vlera minimale e një kuote është 1,000 lekë. Shoqëria në fillimin e aktivitetit të saj disponon 100 kuota.

NENI 7

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “Ogilvy” sh.p.k. do të jetë : Hartimi, projektimi, zbatimi i fushatave të publicitetit në forma të ndryshme të komunikimit publik dhe në mjetet e informacionit publik si gazeta, revista, publikime mujore, radio, televizione.



Realizimi i spektakleve, filmave, shfaqjeve me karakter argëtues, punimeve grafike, reklamave radiofonike dhe televizive, shtypshkrimeve të formateve të ndryshme me karakter informativ dhe publicistik.

Organizim i aktiviteteve turistike, transportit për vete e për të tjerët.

Veprimtari në fushën e eksport-importit , tregtim brenda vendit me shumicë e me pakicë të letrës, bojrave, pajisjeve elektrike dhe elektronike, mobiljeve, kozmetikës, veshjeve, mallrave ushqimore dhe pijeve, pajisjeve hidrosanitare dhe cdo malli tjetër që lidhet me shërbimet e lartëpërmendura të shoqërisë;

Aktivitet tregtar duke hapur dyqane për shitjen e mallrave të konsumit të gjërë, bar-bufe, kinkaleri, ekspozita, magazina e supermarkate, hotele të ndryshme në të gjithë territorin e vendit.

Ndërtime, projektme të ndërtesave civile, publike, fetare, industriale, monumentale, vepra murale për komplekse të prodhimit të energjisë, punime restaurimi, shtrim rrugësh, punime hidraulike, ujsjellësa, kanalizime, impiante të ujitjes, ndërtime molesh, skelash, dokeve impiante të ngritjes dhe të pastrimit të ujrave, për ngritjen e impianteve për trajtimin e plehrave, punime të shfrytëzimit të tokës, gërmime, përfshirë dhe gërmime arkeologjike, nxjerrje, përpunim dhe tregtim të materialeve që kanë të bëjnë me ndërtimet (inerte, mermer etj.)



Kryerja e shërbimeve të ndryshme për shitjen , blerjen, dhënien me qera si dhe cdo lloj transaksioni tjetër për pasuritë e paluajtshme;

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë sipërmarrëse të shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari tjetër industriale tregtare, financiare dhe që do të konsiderohet nga ortakët, e nevojshme dhe e pershtatshme për aritjen e objektit të shoqërisë.

NENI 8

Ortakët Themelues, kanë vendosur që si Administrator i Shoqërisë "Ogilvy" Sh.p.k. të jetë Z. Fisnik ISMAILI

Ai përgjigjet mbi bazën e kompetencave të tija të përcaktuara në aktet e themelimit të shoqërisë. Gjithashtu pas miratimit të marrë nga ortakët e tjerë, konfirmon emrat e ortakëve që mund të shtohen , pjesët e kapitalit themeltar si dhe shumën e derdhur nga secili prej tyre .

Gjithashtu ai përgjigjet për administrimin e vlerave pasurore të Shoqërisë , të cdo natyre qofshin , të shlyejë detyrimet që ka shoqëria me të tretët , të bëjë mbi bazën e kontributeve të dhëna prej ortakëve shpërndarjen e fitimit. Brënda kompetencave , Administratori i emëruar nga ortakët mund të caktojë për drejtimin e shoqërisë dhe një Drejtor ekzekutiv, me një afat kohe të përcaktuar.

Si organ ekzekutiv i Shoqërisë "Ogilvy"sh.p.k., të drejtat dhe detyrat e Administratorit , rregullohen me Aktet Themeluese të Shoqërisë, Statuti, legjisilacioni tregtar, si dhe me aktet e tjera normative të nxjerra nga asambleja e Ortakëve , apo dhe me marreveshje të tjera të vecanta .

NENI 9

Mandati i **Administratorit Fisnik ISMAILI** për administrimin në këtë shoqëri, është për një periudhë 3 vitesh financiare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori apo ai që i delegohet ky pushtet , ka të gjitha kompetencat të cilat ai deklarohe se i njeh dhe i pranon , për të kryer të gjitha detyrimet që i lindin në bazë të statutit të Shoqërisë "Ogilvy"sh.p.k. sikurse parashikohet në legjisilacionin e Shtetit Shqiptar dhe në mënyrë të vecantë në Ligjet per Shoqerite Tregtare.

NENI 10


Kjo Kontratë Themelimi hartohet në Tiranë në 4 ekzemplarë origjinalë , duke patur secila nga kopjet vlerë të barabartë ligjore e kuptimore .

NENI 11


Ortakët (perfaqsesit e mandatuar) pasi u njohën dhe kuptuan drejt të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Akt-Themelues i Shoqërisë "Ogilvy"sh.p.k. e gjetën të drejtë dhe konform vullnetit të tyre të brëndëshëm, e firmosën atë.


ORTAKËT THEMELUES

Për Znj. Aimilia TSEIMAZIDOU
përfaqsesi me prokurë
Z.Fisnik ISMAILI



Z. Mojmir OCVIRK





STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ OGILVY ” SH.P.K.

KREU I

FORMA, EMRI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1

FORMA

Krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionon shqiptar në fuqi dhe vecanërisht, por jo ekskluzivisht, me ligjin Nr 7632 datë 04.11.1992 “ Per dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregëtar”, ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 “ Për shoqëritë tregëtare” dhe aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë, si dhe me dispozitat e aktit themelues të shoqërisë që i bashkëngjiten këtij Statuti.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë është “ Ogilvy ” sh.p.k.

Neni 3

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i kësaj shoqërie është:

Hartimi, projektimi, zbatimi i fushatave të publicitetit në forma të ndryshme të komunikimit publik dhe në mjetet e informacionit publik si gazeta, revista, publikime mujore, radio, televizione.

Realizimi i spektakleve, filmave, shfaqjeve me karakter argëtues, punimeve grafike, reklamave radiofonike dhe televizive, shtypshkrimeve të formateve të ndryshme me karakter informativ dhe publicistik.

Organizim i aktiviteteve turistike, transportit për vete e për të tjerët.

Veprimtari në fushën e eksport-importit, tregtim brënda vendit me shumicë e me pakicë të letrës, bojrave, pajisjeve elektrike dhe elektronike, mobiljeve, kozmetikës, veshjeve, mallrave ushqimore dhe pijeve, pajisjeve hidrosanitare dhe cdo malli tjetër që lidhet me shërbimet e lartpërmendura të shoqërisë;

Aktivitet tregtar duke hapur dyqane për shitjen e mallrave të konsumit të gjërë, bar-bufe, kinkaleri, ekspozita, magazina e supermarkate, hotele të ndryshme në të gjithë territorin e vendit.

Ndërtime, projektme të ndërtesave civile, publike, fetare, industriale, monumentale, vepra murale për komplekse të prodhimit të energjisë, punime restaurimi,

Valon Xhaq

shtrim rrugësh, punime hidraulike, ujsjellësa, kanalizime, impiante të ujitjes, ndërtime molesh, skelash, dokeve impiante të ngritjes dhe të pastrimit të ujrave, për ngritjen e impianteve për trajtimin e plehrave, punime të shfrytëzimit të tokës, gërmime, përfshirë dhe gërmime arkeologjike, nxjerrje, përpunim dhe tregtim të materialeve që kanë të bëjnë me ndërtimet (inerte, mermer etj.)

Kryerja e shërbimeve të ndryshme për shitjen, blerjen, dhënien me qera si dhe cdo lloj transaksioni tjetër për pasuritë e paluajtshme;

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë sipërmarrëse të shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari tjetër industriale tregtare, financiare dhe që do të konsiderohet nga ortakët, e nevojshme dhe e pershtatshme për aritjen e objektit të shoqërisë.

Neni 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë ndodhet në Bulevardin "Deshmoret e Kombit" Zyra A2, Kati V, Kulla II, Tiranë, Shqipëri

Neni 5

KOHË ZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë 30 vjeçare duke filluar nga data e regjistrimit të saj në gjykatë.

Kjo periudhe mund të zgjatet tej këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve, ose të shkurtohet kur shoqëria priset para kohe.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, LËNIA DHE TRASFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR,

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë

Verifikohet plotësisht se kapitali themeltar i shoqërisë është derdhur tërësisht në Bankën Raiffeisen Bank, dega Tirana Qëndrore.

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin, proporcionalisht me shumën e shtuar.

Shoqëria mund ta zvogelojë kapitalin e saj. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga vendimi i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, në të cilën janë pjesëmarrës ose përfaqsohen të gjithë ortakët.

Dalton Xhe

Neni 7

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm :

1. Z. Mojmir OCVIRK ortak mazhoritar , kontribon me shumën 51,000 Lekë.
2. Shoqëri "A.T.T.P. Advertising Societe Anonyme" S.A. kontribon me shumën 24,500 Lekë.
3. Z. Fisnik Ismaili kontribuon në shumën 12,250 Lekë
4. Z.Valon Xhaferi kontribuon në shumën 12,250 Lekë

Neni 8

PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

Në bazë të kontributit të sipërpërmendur kapitali është ndarë në pjesë të barabarta ku vlera nominale (kuota) u përcaktua 1,000 lekë.

Të gjitha pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen , shlyhen plotësisht, pastaj i shpërndahet ortakut sipas ndarjes së mësipërme.

Neni 9

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Kuotat janë emërore dhe të transferueshme .

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transmentueshme me rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen të tretëve vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, në të cilën janë pjesëmarrës ose përfaqsohen të gjithë ortakët.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLI I SHOQERISE

Neni 10

ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE VENDIMET E SAJ.

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, merren në përputhje me ligjin me statutin e shoqërisë dhe aktin e themelimit, kanë fuqi detyruese për të gjithë organizmat e shoqërisë , edhe pse jo të pranishëm dhe jo dakort .

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja Asamblesë së Ortakëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Ajo e zakonshme vendos për çeshtje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe

Valon Xhaferi

likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj. Asambleja e Ortakëve në mbledhjen e Jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në forma të tjera etj.

Mbledhje drejtohet nga njëri prej ortakëve që është njëkohësisht Administrator ose nga ai që është në këmbë të tij.

Verbalet e mbledhjes përpilohen , aprovohen dhe firmosen nga të gjithë ortakët ose përfaqësuesit e tyre, kur nuk përpilohen nga një noter.

Si drejtues Ligjor i Shoqërisë është Z.Fisnik ISMAILI

Neni 11

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga një Administrator, që në rastin konkret është dhe ortak i Shoqërisë.

Në rast të një administratori të jashtëm Ai ose Ata , emërohen dhe shkarkohen me miratim të Asamblesë së Zakonshme të ortakëve të shoqërisë. Emërimi i tyre bëhet për një kohëzgjatje prej tre vjetësh financiar, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshem.

Administratori mbledh në selinë e shoqërisë ose gjetiu, në Slloveni ose në Greqi, të gjitha herët që Ai do ta shikojë të arsyeshme ose bëhet kërkesë Asamblesë e Ortakëve.

Në marrëdhënie me ortakët dhe të tretët Administratori (në rast se emërohet nga Asambleja e Ortakëve) ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë edhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë dhe përjashtimin e atyre kopetencave që ligji dhe statuti i shoqërisë ua japin shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve, qoftë për shkelje ligjore qoftë për shkelje të statutit të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të blejë, shesi, ndryshojë pasuri të tundshme , vetura dhe makina, të blejë tituj aksionesh, të tundshme dhe të patundshme, të marrë përsipër pjesëmarrje aksionare ose kapitale në shoqëri tregtare të çfarëdo lloji . të blejë pasuri të tundshme dhe të patundshme, të marrë përsipër , të heqë dorë nga hipoteka legale, autorizon operacione pranë instituteve bankare në përgjithësi dhe pranë cdo zyre tjetër private ose publike, të vendosë lënien e kredive, operacione bankare për cdo import, hua aktive dhe pasive, të marrë dhe të pushojë nëpunës dhe punëtorë, emëroje prokuratorë në negociata duke përcaktuar dhe administratori i ruhet e drejta për të emëruar drejtuesit teknik dhe administrativ.

Neni 12

Firma e shoqërisë dhe përfaqsimi legal i saj në çdo seli administrative dhe gjyqsore, përfshi dhe gjykimet e Gjykatës së Lartë duhet ti takojë : Administratorit të shoqërisë ose një anëtar të këshillit të deleguar nga vetë Ai me mandat të shprehur.

Valon Xhaferi

Neni 13

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

Në rast nevojë ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar i emërtuar për gjashtë vite financiare, me mundësi rizgjedhje nga Asambleja e Ortakëve

Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si dhe emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 14

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga Administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati të caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 15

DIVIDENTET

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve përcakton pjesën që u takon atyre në formën e dividendëve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet nga Ortaku, në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5% e fitimit të cdo viti deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

KREU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 16

ZGJATJA E AFATIT

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, zgjatja e tij mund të vendoset nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Valon Xhaferi

Neni 17

PRISHJA

Shoqëria priset në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve ku bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 16 ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara me ligj.

Shoqëria nuk priset kur ortakët falimentojnë, bëhen të paafte ose vdesin.

Neni 18

LIKUIDIMI

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve emërton një ose disa likuidues të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit Asambleja e Ortakëve vendos kontributet përkatëse. Likuiduesi jep kapitalet e mbetura ortakëve të shoqërisë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

SHNDËRRIMI I SHOQËRISË

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive, shoqëri komandite ose anonime mund të kryhet me miratim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 20

MOSMARRËVESHJET

Të gjitha mosmarrëveshjet të pazgjidhshme, që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës së rrethit.


Gjykatë kompetente për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të rrethit Tiranë.

[Signature]
[Signature]

Beton Ishaq
[Signature]

Neni 21

Për gjithshka jo të parashikuar në këtë statut do të respektohen normat ligjore të shtetit shqiptar dhe kur nevojitet ato ndërkombëtare.



ORTAKËT

Për Znj. Aimilia TSEIMAZIDOU
përfaqesuesi me prokurë
Z.Fisnik ISMAILI

Z. Fisnik ISMAILI

Z. Mojmir OCVIRK

Z. Valon XHAFERI